

**Ministria e Ekonomisë si shfrytëzuese e projektit "Përgjegjësia sociale korporative dhe engjëjt e biznesit - forcë lëvizëse për sektorin privat", financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga kompania konsulente Planet.**

**shpall**

## **THIRRJE PUBLIKE**

**për përzgjedhjen e organizatave të regjistruara në përputhje me Ligjin për shoqatat dhe fondacionet, të cilave do t'u ofrohen shërbime konsulente dhe trajnime për formimin e rrjeteve të engjëjve të biznesit**

### **I.**

Lëndë e kësaj Thirrje publike është ofrimi i trajnimeve dhe shërbime konsulente këshillimit për organizatat, të cilat kanë për qëllim formimin e rrjeteve të engjëjve të biznesit në drejtim të përmirësimit të start-up ekosistemit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

### **II.**

Në thirrjen publike mund të paraqiten Organizatat që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Të jenë të formuara për qëllime që lidhen me zhvillimin, mbështetjen dhe avansimin e sipërmarrësisë dhe NVM-ve;
- Të ketë përvojë minimale 3 vjeçare në zbatimin e projekteve që kanë të bëjnë me shërbimet e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- Të ketë të paktën 2 (dy) të punësuar.

### **III**

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Formular "Fletëparaqitje –Enguj të biznesit 2023" (*mund të merret nga arkivi ose nga faqja [www.economy.gov.mk](http://www.economy.gov.mk)*);
- Statuti i shoqatës ose fondacionit;
- Gjendja aktuale nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj;
- Listë e personave aktualisht të punësuar nga Agjencia e punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj;
- Biografia e personave të punësuar në shoqatën ose fondacionin;
- Lista e referencës së projekteve të realizuara dhe/ose klientëve;
- Referencat nga kryerja e trajnimeve për klientët.

#### IV.

Kriteret e përzgjedhjes:

1. Lista referencë e projekteve dhe trajnimeve të realizuara që janë të lidhura me qëllimin e masës 40 pikë;
2. Biografia e punës e personave të punësuar 30 pikë,
3. Referenca nga shërbimet e realizuara te klientët 20 pikë,
4. Vitet e ekzistencës së organizatës 10 pikë.

#### V

Mënyra e paraqitjes së kërkesave:

Formulari i plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet në mënyrë elektronike në adresën elektronike: [sme@economy.gov.mk](mailto:sme@economy.gov.mk), jo më vonë se **25 tetor 2023**, me shënimin për thirrjen publike për përzgjedhjen e shoqatave dhe fondacioneve për sigurimin e shërbimeve konsulente dhe trajnime për formimin e rrjeteve të engjëjve të biznesit.

Aplikimet të cilat do të arrijnë pas datës 25 tetor 2023 nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit.

Formularet do të shqyrtohen nga ekipi i projektit i cili do ta realizojë projektin.

Sipas aktiviteteve programore të projektit është planifikuar të përzgjidhen 4 (katër) organizata.

Organizatat e përzgjedhura në bazë të kësaj thirrje do të marrin shërbimet e mëposhtme:

- Mbështetje teknike në definimin e qëllimeve dhe shërbimeve të biznesit të rrjeteve të engjëjve të biznesit;
- Mbështetje teknike në strukturimin e funksionimit të rrjeteve të engjëjve të biznesit;
- Shërbime konsulente dhe trajnime për evaluimin e ideve dhe planeve të biznesit;
- Shërbime konsulente dhe trajnime të engjëjve potencialë të biznesit për investim në ide të reja biznesi;
- Shërbime konsulente dhe trajnime të sipërmarrësve potencialë-anëtarë të rrjeteve të engjëjve të biznesit për prezantimin e ideve të reja të biznesit.

Shërbimet do ti realizojnë konsulentë të angazhuar nga kompania konsulente Planet në mënyrë dhe dinamikë që do të përcaktohet pas seleksionimit të kryer nga kjo thirrje.

Tel 02 3093431